



# RREGULLA KORPORATIVE PËR MBROJTJEN E PRIVATËSISË

## 1. Hyrje

### Preambula

- (1) Mbrojtja e të dhënave personale të shfrytëzuesve, të punësuarve dhe personave të tjerë lidhur me Grupacionin Dojçe Telekom është prioritet kryesor për të gjitha kompanitë në kuadër të Grupacionit Dojçe Telekom.
- (2) Kompanitë e Grupacionit Dojçe Telekom janë të vetëdijshme se suksesi i Dojçe Telekomit në tërësi varet jo vetëm nga rrjetimi global i qarkullimit të informacioneve, por para së gjithash edhe nga puna e besueshme dhe e sigurt me të dhënat personale.
- (3) Në shumë fusha, Grupacioni Dojçe Telekom perceptohet nga shfrytëzuesit dhe publiku i gjerë si një subjekt i vetëm. Prandaj, është në interesin reciprok të kompanive të Grupacionit Dojçe Telekom që të japin një kontribut të rëndësishëm në suksesin e përbashkët të kompanisë dhe ta mbështesin pretendimin e Grupacionit Dojçe Telekom për të qenë një ofrues i produkteve me cilësi të lartë dhe shërbimeve inovative nëpërmjet implementimit të këtyre Rregullave korporative për mbrojtjen e privatësisë.
- (4) Duke i siguruar këto Rregulla korporative për mbrojtjen e privatësisë, Grupacioni Dojçe Telekom krijon një nivel të standardizuar dhe të lartë të mbrojtjes së privatësisë së të dhënave në mbarë botën, i cili zbatohet për përdorimin e të dhënave si brenda një kompanie ashtu edhe ndërmjet të gjitha kompanive dhe i referohet transferimit të të dhënave brenda Gjermanisë dhe ndërkombëtarisht. Brenda Grupacionit Dojçe Telekom, të dhënat personale duhet të përpunohen nga marrësi në përputhje me parimet e ligjit për mbrojtjen e të dhënave të zbatueshme dhe të vlefshme për palën transferuese.

## 2. Pjesa kryesore

### Pjesa e parë Fushëveprimi

#### § 1 Natyra ligjore e Rregullave korporative për mbrojtjen e privatësisë

Rregullat korporative për mbrojtjen e privatësisë janë të detyrueshme në lidhje me përpunimin e të dhënave personale (sipas dokumentit të punës 256, neni 29 i grupit të punës të Komisionit Evropian<sup>1</sup>) për të gjitha kompanitë e Grupacionit Dojçe Telekom, të cilat i kanë miratuar ato në bazë ligjore të detyrueshme. Rregullat korporative për mbrojtjen e privatësisë janë gjithashtu të detyrueshme për të gjitha kompanitë që mund t'u kërkojnë nga Dojçe Telekom t'i miratojnë ato, si dhe për të gjitha kompanitë që i kanë miratuar ato në baza vullnetare, pavarësisht se ku janë mbledhur të dhënat.

#### § 2 Fushëveprimi i zbatimit

Rregullat korporative për mbrojtjen e privatësisë zbatohen në të gjitha llojet e përpunimit të të dhënave personale në kuadër të Grupacionit Dojçe Telekom, pavarësisht asaj se ku janë grumbulluar të dhënat. Të dhënat personale përpunohen në kuadër të Grupacionit Dojçe Telekom për qëllimet vijuese, veçanërisht për:

- a) udhëheqjen e të dhënave të të punësuarve gjatë inicimit, implementimit dhe përpunimit të kontratave për punësim dhe për t'iu drejtuar të punësuarve me produktet dhe shërbimet që u ofrohen nga Grupacioni Dojçe Telekom dhe prej palëve të treta;
- b) inicimin, implementimin dhe përpunimin e kontratave me abonues afaristë dhe privatë, si edhe për kryerjen e aktiviteteve për marketing dhe hulumtim të tregut për qëllimet e informimit të abonuesve dhe palëve të treta të interesuara për produktet dhe shërbimet që ua ofron Grupacioni Dojçe Telekom ose palët e treta, në mënyrë përkatëse.
- c) inicimit dhe implementimit të kontratave me ofruesit e shërbimeve të Grupacionit Dojçe Telekom, si pjesë e sigurimit të shërbimeve të Grupacionit Dojçe Telekom.
- ç) mundësit të veprimit të përshtatshëm me palët e tjera të treta, veçanërisht aksionarë, partnerë apo vizitorë si edhe respektimin e rregullave ligjore të obligueshme

Të dhënat përdoren në pajtim me qëllimet vijuese dhe të ardhshme të kompanive të Grupacionit Dojçe Telekom, që përfshijnë sigurimin e shërbimeve telekomunikuese, shërbimeve digjitale për abonuesit privatë dhe afaristë, shërbimeve IT (duke i përfshirë shërbimet e data qendrave) dhe shërbimeve këshilldhënëse.

#### § 3 Lidhja me rregulloret e tjera ligjore

- (1) Dispozitat e Rregullave korporative për mbrojtjen e privatësisë janë krijuar për të siguruar një nivel të lartë dhe të standardizuar të privatësisë së të dhënave në të gjithë Grupacionin Dojçe Telekom. Detyrimet ligjore dhe rregullativat ekzistuese që kompanitë individuale duhet t'i respektojnë në lidhje me përpunimin e të dhënave personale, të cilat

Ky dokument është pronësi intelektuale e Makedonski Telekom SHA – Shkup. Çdo botim ose kopjim i të njëjtit lejohet vetëm për përdorim intern. Versionet valide të rregullativave interne janë në formatin elektronik dhe janë në dispozicion përmes listës Master të rregullativave interne të Makedonski Telekomit SHA – Shkup.

shkojnë përtej parimeve të përcaktuara në këto Rregulla korporative për mbrojtjen e privatësisë ose të cilat përmbajnë kufizime shtesë në përpunimin dhe përdorimin e të dhënave personale, mbeten të paprekura nga këto Rregulla korporative për mbrojtjen e privatësisë.

- (2) Të dhënat që janë mbledhur në Evropë përpunohen në përgjithësi në pajtim me rregullat ligjore të cilat janë valide në vendin në të cilin janë grumbulluar të dhënat, pavarësisht asaj se ku përpunohen të dhënat, por së paku në pajtim me kërkesat që i përmbajnë këto Rregulla korporative për mbrojtjen e privatësisë.
- (3) Zbatueshmëria e legjislacionit nacional në fushën e sigurisë së shtetit, mbrojtjes kombëtare ose sigurisë publike ose me qëllim të parandalimit dhe hetimit të veprave penale dhe ndjekjes penale të autorëve të veprave penale, për të cilat të dhënat u transferohen palëve të treta, mbeten të paprekura nga dispozitat e këtyre Rregullave korporative për mbrojtjen e privatësisë. Nëse një kompani përcakton se një pjesë e rëndësishme e këtyre Rregullave korporative për mbrojtjen e privatësisë janë në kundërshtim me dispozitat nacionale për mbrojtjen e privatësisë së të dhënave, gjë që ndikon në pamundësinë e Kompanisë për të miratuar këto Rregulla korporative për mbrojtjen e privatësisë, atëherë Zyrtari për mbrojtjen e të dhënave të Grupacionit Dojçe Telekom duhet të informohen pa vonesë. Organi përgjegjës kompetent i kompanisë do të përfshihet në rolin e ndërmjetësit.

#### § 4 Shfuqizimi dhe pezullimi

Rregullat korporative për mbrojtjen e privatësisë pushojnë së zbatuari për një kompani nëse ajo largohet nga Grupacioni Dojçe Telekom ose i pezullon këto rregulla. Megjithatë, përfundimi ose anulimi i Rregullave korporative për mbrojtjen e privatësisë nuk e lironjë Kompaninë nga detyrimet dhe/ose dispozitat e Rregullave korporative për mbrojtjen e privatësisë që zbatohen për përdorimin e të dhënave të transferuara tashmë. Transferimi i mëtejshëm i të dhënave nga dhe drejt kësaj kompanie mund të ndodhë nëse parashikohen rregulla të tjera të përshtatshme procedurale në përputhje me kërkesat e legjislacionit evropian.

## Pjesa e dytë Parimet

### Seksioni 1 Transparenca e përpunimit të të dhënave

#### § 5 Detyrimi dhe informimi

Subjektet e të dhënave personale duhet të informohen për atë se si përdoren të dhënat e tyre personale në pajtim me legjislacionin kompetent dhe nën kushtet vijuese.

#### § 6 Përmbajtja dhe forma e informacioneve

- (1) Kompania duhet në mënyrë përkatëse t'i informojë subjektet e të dhënave personale për:
  - a) Identitetin e kontrolluesit (kontrolluesve) dhe për të dhënat e tyre për kontakt;
  - b) Të dhënat për kontakt të zyrtarit për mbrojtjen e të dhënave;
  - c) qëllimin e përpunimit të të dhënave, si edhe bazën ligjore për përpunim dhe periudhën e ruajtjes së të dhënave personale;
  - ç) nëse të dhënat personale transferohen tek palë të treta, pranuesi, vëllimi dhe qëllimi (qëllimet) i transferimit të tillë duhet të jenë të njohura;
  - d) të dhënat e subjekteve të të dhënave personale lidhur me përpunimin e të dhënave të tyre.
- (2) Pavarësisht medias së zgjedhur, subjektet e të dhënave personale duhet t'i marrin këto informacione në mënyrë të qartë dhe lehtësisht të kuptueshëm.

#### § 7 Qasje në informacione

Informacionet kanë qasje për subjektet e të dhënave personale kur të dhënat grumbullohen dhe në mënyrë të njëpasnjëshme, gjithmonë kur dorëzohet kërkesë për informacion.

#### § 8 Evidentimi i të gjitha kategorive të aktiviteteve për përpunimin e të dhënave

Kompanitë mbajnë evidencë për të gjitha kategoritë e aktiviteteve për përpunimin e të dhënave që i bëjnë.

Evidenca i përmban informacionet vijuese:

- a) emri i të dhënave për kontakt o kompanisë, i përfaqësuesit dhe zyrtarit për mbrojtjen e të dhënave;
- b) përshkrimi i kategorive të aktiviteteve dhe qëllimeve të përpunimit;
- c) kategori të pranuesve dhe palëve të treta të cilave do t'u zbardhen apo transferohen të dhënat;
- ç) emrat e vendeve të treta dhe dokumentet për mbrojtjen përkatëse të këtyre Rregullave korporative për mbrojtjen e privatësisë nuk janë të aplikueshme;
- d) aty ku është e mundur, afatet kohore për fshirje dhe
- dh) aty ku është e mundur, përshkrimi i përgjithshëm i masave teknike dhe i masave organizative të sigurisë.

### Seksioni 2

#### Kushte për përpunimin e lejuar të të dhënave personale

#### § 9 Parime

(1) Të dhënat personale do të përpunohen vetëm me kushtet vijuese dhe nuk do të përpunohen për qëllime të tjera përveç për qëllimet për të cilat janë grumbulluar fillimisht.

(2) Përpunimi i të dhënave të grumbulluara për qëllime të tjera do të lejohet vetëm nëse plotësohen kushtet për lejim në pajtim me kushtet vijuese (kufizimi i qëllimit).

#### §10 Lejohet përdorimi i të dhënave personale

Të dhënat personale mund të përpunohen nëse janë përbushur një ose më shumë nga kriteret në vijim:

- (a) në aspektin ligjor në mënyrë eksplicite lejohet të dhënat të përpunohen në mënyrën e planifikuar;
- (b) subjekti i të dhënave personale ka dhënë pëlqim për përpunimin e të dhënave të tij;
- (c) është e nevojshme të përpunohen të dhënat në këtë mënyrë në mënyrë që kompania t'i përbushë detyrimet e saj kontraktuale me subjektin e të dhënave personale, duke i përfshirë detyrimet e saj të informimit dhe/ose detyrimet dytësore ose në mënyrë që kompania t'i zbatojë masat para-kontraktuale ose paskontraktuale për inicimin ose përpunimin e një kontrate me kërkesë të subjektit të të dhënave personale;
- (ç) të dhënat duhet të përpunohen për qëllimet e përbushjes së obligimit ligjor nga kompania;
- (d) është e nevojshme të përpunohen të dhënat që të mbrohen interesat vitale të subjektit të të dhënave personale;
- (dh) është e nevojshme të përpunohen të dhënat që të kryhet një detyrë e caktuar që është me interes publik ose e cila paraqet një pjesë të zbatimit të autorizimit publik dhe me të cilën obligohet kompania ose një palë e tretë të cilës i janë bartur të dhënat
- e) është e nevojshme të përpunohen të dhënat me qëllim që të realizohen interesat legjitime të kompanisë ose palës së tretë/palëve të treta deri tek të cilat barten të dhënat, me kusht që këto interesa të mos mbizotërojnë mbi interesat e subjektit të të dhënave personale që janë lëndë e mbrojtjes.

#### § 11 Pëlqimi i subjektit të të dhënave personale

Vlerësohet se subjekti i të dhënave personale e ka dhënë pëlqimin e vet në bazë të § 10 (1), pikës b) të këtyre Rregullave korporative për mbrojtjen e privatësisë nëse:

(a) Pëlqimi jepet shprehimisht, vullnetarisht dhe bazuar në informacionin e subjektit të të dhënave personale në lidhje me qëllimin për të cilin ai/ajo pajtohet. Formulimi i deklaratave të pëlqimit duhet të jetë mjaft i saktë dhe në të njëjtën kohë t'i informojë subjektet e të dhënave personale për të drejtën e tyre për të tërhequr pëlqimin e tyre në çdo kohë. Për modelet e biznesit ku tërheqja çon në mospërbushje të detyrimeve kontraktuale, subjekti i të dhënave personale duhet të informohet për këtë.

Pëlqimi është marrë në një formë të përshtatshme për rrethanat (forma e shkruar). Në raste të jashtëzakonshme, pëlqimi mund të merret gojarisht, nëse deklarata e pëlqimit dhe rrethanat e veçanta që e bëjnë pëlqimin gojor të përshtatshme janë të dokumentuara mjaftueshëm.

#### § 12 Vendime individuale automatike duke përfshirë profilimin

- a) Vendimet që vlerësojnë aspektet individuale të një personi të caktuar (profilimi) dhe që mund të rezultojnë në pasoja ligjore për të ose që mund të kenë një efekt negativ të konsiderueshëm mbi të, nuk duhet të bazohen vetëm në përpunimin e automatizuar të të dhënave. Kjo përfshin veçanërisht vendimet për të cilat janë të rëndësishme të dhënat mbi besueshmërinë, përshtatshmërinë profesionale ose shëndetin e subjektit të të dhënave.
- b) Nëse, në raste individuale, ekziston nevojë objektive për marrjen e vendimeve të automatizuara, subjekti i të dhënave personale duhet të informohet menjëherë për rezultatin e vendimit të automatizuar dhe t'i jepet mundësia për të komentuar brenda një periudhe të përshtatshme kohore. Komentet e subjektit të të dhënave personale do të merren parasysh siç duhet përpara se të merret vendimi përfundimtar.

#### § 13 Përpunimi i të dhënave personale me qëllim të marketingut të drejtpërdrejtë

Aty ku të dhënat përpunohen për qëllime të marketingut të drejtpërdrejtë, subjektet e të dhënave personale duhet të:

- a) informohen për mënyrën në të cilën të dhënat e tyre do të përpunohen me qëllim të marketingut të drejtë përdrejtë;
  - b) të informohen për të drejtën e tyre të kërkojnë në çdo kohë të dhënat e tyre personale të përpunohen me qëllim të komunikimit të drejtpërdrejtë të marketingut dhe
  - c) të informojnë për aplikimin e të drejtës së tyre të mos marrin komunikime të tilla.
- ç) ata duhet të marrin informacione veçanërisht për kompaninë ku duhet të dorëzohet ankesa.

#### § 14 Kategori të veçanta të të dhënave personale

(1) Përpunimi i kategorive të veçanta të të dhënave lejohet vetëm kur rregullohet me rregullore ligjore ose në bazë të pëlqimit të marrë paraprakisht nga subjekti i të dhënave personale. Gjithashtu, përpunimi do të lejohet, nëse është e nevojshme, të përpunohen të dhënat me qëllim të përbushjes së të drejtave dhe detyrimeve të shoqërisë në fushën e së drejtës së punës, me kusht që të merren masa adekuate mbrojtëse dhe e njëjta të mos ndalohet me ligjet pozitive.

(2) Përpara se të fillojë një përpunim i tillë, kompania informon zyrtarin e saj për mbrojtjen e të dhënave personale dhe e dokumenton këtë procedurë. Gjatë vlerësimit të lejueshmërisë, është e nevojshme t'i kushtohet vëmendje e veçantë natyrës, fushëveprimit, qëllimit, domosdoshmërisë dhe bazës ligjore për përpunimin e të dhënave personale.

#### § 15 Minimizimi i të dhënave, shmangia e përpunimit të panevojshëm të të dhënave, kufizimi i ruajtjes, anonimizimi dhe pseudonimizimi

Të dhënat personale duhet të jenë të përshtatshme, relevante dhe jo të tepruara në lidhje me qëllimin specifik për të cilin do të përpunohen (minimizimi i të dhënave). Të dhënat përpunohen brenda një aplikacioni specifik vetëm kur është e nevojshme (shmangia e përpunimit të panevojshëm të të dhënave). Të dhënat duhet të ruhen në një formë që lejon identifikimin e subjekteve të të dhënave personale për një periudhë që nuk e kalon kohën e nevojshme për përpunimin e tyre (kufizimi i ruajtjes). Kudo që është e mundur dhe ekonomikisht e arsyeshme, duhet të përdoren procedura për të fshirë të dhënat e identifikimit të subjekteve të të dhënave personale (anonimizim) ose për të zëvendësuar të dhënat e identifikimit me karakteristika të tjera (pseudonimizim).

#### § 16 Ndalesë për detyrime

Përdorimi i shërbimeve ose marrja e produkteve dhe/ose shërbimeve nuk duhet të kushtëzohet me pëlqimin e subjekteve të të dhënave personale për përdorimin e të dhënave të tyre për qëllime të ndryshme nga fillimi ose përmbushja e një kontrate. Kjo do të zbatohet vetëm nëse nuk është e mundur ose nuk është e mundur ose nuk është e arsyeshme që subjekti i të dhënave personale të përdorë shërbime ose produkte të ngjashme.

### Seksioni 3

#### Transferimi i të dhënave personale

##### § 17 Natyra dhe qëllimi i transferimit të të dhënave personale

- (1) Të dhënat personale mund të transferohen vetëm kur pala marrëse merr përsipër përgjegjësinë për të dhënat e marra (transferimin) ose kur marrësi i përpunon të dhënat vetëm në përputhje me udhëzimet dhe kërkesat e palës që kryen transferimin (marrëveshje për përpunimin e të dhënave).
- (2) Të dhënat personale mund të transferohen vetëm për qëllimet e lejuara në përputhje me § 10 të këtyre Rregullave korporative për mbrojtjen e privatësisë si pjesë e aktiviteteve afariste ose detyrimeve ligjore të kompanisë ose pas marrjes së pëlqimit të subjekteve të të dhënave personale.

##### § 18 Transferimi i të dhënave

- (1) Nëse një kompani transferon të dhëna tek organet që kanë selinë e tyre në një vend të tretë ose transferon të dhëna përtej kufijve nacional, duhet të ndërmerren hapa për të siguruar që të dhënat të transferohen në mënyrë korrekte. Masat e duhura për të mbrojtur privatësinë dhe sigurinë e të dhënave do të bien dakord me marrësin përpara se të dhënat të transferohen. Përveç kësaj, të dhënat personale, veçanërisht të dhënat e mbledhura në BE ose EEO, mund t'u transferohen kontrollorëve jashtë Bashkimit Evropian vetëm nëse sigurohet një nivel adekuat i mbrojtjes së privatësisë së të dhënave duke përdorur këto Rregulla korporative për mbrojtjen e privatësisë ose masa të tjera të përshtatshme, siç janë klauzolat standarde kontraktuale të BE-së ose marrëveshje kontraktuale individuale që plotësojnë kërkesat përkatëse të ligjit evropian dhe të drejtat e zbatueshme të subjekteve të të dhënave personale dhe mjetet juridike të zbatueshme të subjekteve të të dhënave personale që janë të disponueshme në kuptimin e Seksionit 5 të këtyre Rregullave korporative për mbrojtjen e privatësisë.
- (2) Në bazë të kërkesave të Grupacionit Dojçe Telekom dhe standardeve të përgjithshme dhe të pranura teknike dhe organizative, duhet të ndërmerren masa përkatëse teknike dhe organizative që të garantohet siguria e të dhënave personale, duke e përfshirë edhe transferimin e tyre në anën tjetër.

##### § 19 Përpunimi i të dhënave për angazhimin e palëve të treta<sup>1</sup>

- (1) Kur një kompani (përdoruese) punëson një palë të tretë (kontraktor) për të ofruar shërbime në emër të saj në përputhje me udhëzimet e saj, atëherë përveç kontratës së shërbimit që rregullon punën që do të kryhet, kontrata përcakton edhe detyrimet e kontraktorit si palë e angazhuar për përpunimin e të dhënave. Këto detyrime i përcaktojnë udhëzimet e përdoruesit në lidhje me llojin dhe mënyrën e përpunimit të të dhënave personale, qëllimin e përpunimit dhe masat teknike dhe organizative të nevojshme për mbrojtjen e të dhënave.
- (2) Kontraktuesi nuk mund t'i përdorë të dhënat personale (që i janë besuar për qëllime të shërbimit) për qëllime të përpunimit të tij ose për qëllime të tilla të palës së tretë, pa pëlqimin paraprak të përdoruesit. Kontraktori do ta njoftojë përdoruesin paraprakisht për planet e mundshme për të transferuar ekzekutimin e shërbimit te nënkontraktorët e palëve të treta, në mënyrë që të përmbushë detyrimet e tij kontraktuale. Përdoruesi ka të drejtë ankimi në lidhje me marrjen në punë të nënkontraktorëve. Nëse lejohet marrja në punë e nënkontraktorëve, kontraktori i detyron ata t'i respektojnë kërkesat që rrjedhin nga kontratat e lidhura ndërmjet kontraktorit dhe përdoruesit.
- (3) Nënkontraktorët zgjidhen sipas aftësisë së tyre për t'i përmbushur kërkesat e lartshënuara.

### Seksioni 4

#### Cilësia dhe siguria e të dhënave

##### § 20 Cilësia e të dhënave

- (1) Të dhënat personale duhet të jenë të sakta dhe aty ku është e domosdoshme, të azhurnohen (saktësia e të dhënave).
- (2) Duke e pasur parasysh qëllimi për të cilin përdoren të dhënat, duhet të ndërmerren masa përkatëse që të sigurohet se

<sup>1</sup> Kjo pjesë nuk është dispozitë në kuptimin e dokumentit të punës 195 të nenit 29 të grupit të punës së Komisionit Evropian.

të gjitha informacionet e pasakta apo të paplota fshihen, bllokohen ose nëse është e domosdoshme korrigjohen.

#### § 21 Siguria e të dhënave – masa teknike dhe organizative – mbrojtje e planifikuar dhe standard e të dhënave

Kompania ndërmerr masa përkatëse teknike dhe organizative për proceset e kompanisë, sistemet TI dhe platformat që përdoren për grumbullimin, përpunimin apo përdorimin e të dhënave që të mbrohen këto të dhëna, ndërsa të cilat vlerësohen në bazë të rregullt lidhur me efikasitetin e tyre.

Masat e tilla duhet të përfshijnë:

- a) parandalimi i qasjes nga persona të paautorizuar për përpunimin e të dhënave në të cilat përpunohen ose përdoren të dhënat personale (kontrolli i qasjes);
- b)) Sigurimi i sistemeve për përpunimin e të dhënave nuk mund të përdoren nga persona të paautorizuar (kontrolli i ndalesës për përdorim);
- c) sigurimi se personat e autorizuar për përdorimin e sistemit për përpunimin e të dhënave mund të qasen vetëm deri tek të dhënat të cilat ka qasje të autorizuar (kontroll të qasjes deri tek të dhënat) dhe se të dhënat personale nuk mundën, gjatë përpunimit, të lexohen, kopjohen, ndryshojnë ose fshihen nga persona të paautorizuar (psh. përmes enkriptimit);
- ç) sigurimi se të dhënat personale nuk mund të lexohen, kopjohen, ndryshojnë ose fshihen nga persona të paautorizuar, gjatë transferimit elektronik, transportit apo evidentimit të mediave për të dhëna dhe se është e mundur të verifikohen dhe identifikohen kontrolluesit deri tek të cilët transferohen të dhënat personale me pajisje për transferimin e të dhënave (kontrolli i transferimit të të dhënave);
- d) sigurimi se është e mundur në mënyrë retroaktive të analizohet dhe shihet nëse dhe prej kujt janë futur të dhënat personale, janë ndryshuar ose fshirë në sistemet për përpunimin e të dhënave (kontrolli i futjes së të dhënave);
- dh) sigurimi se të dhënat personale autsore mund të përpunohen vetëm në pajtim me instruksionet e përdoruesit (kontrolli i kontraktorit);
- e) sigurimi se të dhënat personale janë të mbrojtura nga shkatërrimi rastësor apo humbja (kontrolli i qasjes);
- ë) sigurimi se të dhënat që janë grumbulluar për qëllime të ndryshme mund të përpunohen ndaras (rregulli i ndarjes).

### **Pjesa e tretë** **Të drejtat e subjekteve të të dhënave personale**

#### § 22 E drejta e qasjes

- (1) Subjektet e të dhënave personale kanë të drejtë në çdo kohë të kontaktojnë cilëndo kompani e cila i përpunon të dhënat e tyre dhe t'i kërkojë informacionet vijuese:
  - a) Të dhënat personale ruhen për to, duke e përfshirë origjinën e tyre dhe pranuesin (pranuesit);
  - b) Qëllimi i përpunimit;
  - c) Personat dhe kontrolluesit deri tek të cilët të dhënat e tyre barten rregullisht, veçanërisht nëse të dhënat transferohen deri tek një vend i tretë;
  - ç) Dispozitat e këtyre Rregullave korporative për mbrojtjen e privatësisë.
- (2) Informacionet përkatëse i vihen në dispozicion kërkuarit në një formë të kuptueshme brenda një periudhe të arsyeshme kohore. Në përgjithësi kjo duhet të bëhet me shkrim ose në mënyrë elektronike. Sigurimi i një kopjeje të printuar të Rregullave korporative për mbrojtjen e privatësisë do të jetë e mjaftueshme si mënyrë për transferimin e informacioneve për kërkesat e tyre.
- (3) Kur kjo është e mjaftueshme sipas legjislatives nacionale relevante, kompania mund të paguaj kompensim për sigurimin e kopjeje shtesë nga informacionet relevante të kërkuara nga subjekti i të dhënave personale.

#### § 23 E drejta e ankimit, e drejta për fshirjen ose bllokimin e të dhënave dhe e drejta e korrigjimit

- (1) Subjektet e të dhënave personale mund të bëjnë ankim kundër përdorimit të të dhënave të tyre në çdo kohë nëse këto të dhëna përdoren për qëllimet të cilat nuk janë të lejueshme ligjërisht.
- (2) Kjo e drejtë ankimi zbatohet edhe në rast se subjektet e të dhënave personale paraprakisht janë pajtuar me përdorimin e të dhënave të tyre
- (3) Kërkesat e justifikuara për fshirje ose bllokim të të dhënave duhet të zbatohen në kohën e duhur. Kërkesa të tilla justifikohen veçanërisht kur baza ligjore për përdorimin e të dhënave pushon së qeni e vlefshme. Nëse subjekti i të dhënave personale ka të drejtë të kërkojë fshirjen e të dhënave, por fshirja e të dhënave nuk është e mundur ose kërkon një përpjekje të madhe disproporcionale, të dhënat do të mbrohen nga përdorimi i paautorizuar me bllokim. Duhet të respektohen periudhat e përcaktuara me ligj të ruajtjes së të dhënave.
- (4) Subjektet e të dhënave personale mund të kërkojnë nga kompania t'i korrigjojë të dhënat personale të cilat i ka për to në çdo kohë, nëse këto të dhëna janë të paplota dhe/apo të pasakta.
- (5) Për modelet afariste në të cilat tërheqja apo fshirja çon drejt mospërmbushjes së obligimeve të dakorduara, subjekti i të dhënave personale duhet të informohet për këtë.

#### § 24 E drejta e ankimit, e drejta e fshirjes apo kufizimit të përpunimit dhe e drejta e korrigjimit

- (1) Subjektet e të dhënave personale mund të kundërshtojnë përdorimin e të dhënave të tyre në çdo kohë nëse këto të dhëna përdoren për qëllime që nuk janë ligjërisht të detyrueshme.

Kjo e drejtë ankimi zbatohet edhe nëse subjektet e të dhënave personale janë dakorduar më parë për përdorimin e të dhënave

të tyre.

Kërkesat legjitime për fshirje ose kufizim të përpunimit duhet të zbatohen me kohë. Kërkesat e tilla janë legjitime veçanërisht kur baza ligjore për përdorimin e të dhënave pushon së qeni e vlefshme. Duhet të respektohen afatet ligjore të ruajtjes.

(2) Subjektet e të dhënave personale mund të kërkojnë nga kompania t'i korrigojnë të dhënat personale të cilat i kanë për ta në çdo kohë, ndërsa nëse këto të dhëna janë të paplota dhe/apo të pasakta.

Për modelet e biznesit kur tërheqja ose fshirja çon drejt mospërbushjes së obligimeve të dakorduara, subjekti i të dhënave personale duhet të informohet për këtë.

§ 25 E drejta e shpjegimit, komentet dhe sanimit

(1) Nëse subjekti i të dhënave personale pretendon se të drejtat e tij/saj janë shkelur nga përpunimi i paligjshëm i të dhënave të tij/saj, veçanërisht duke ofruar prova që konfirmojnë shkeljen e këtyre Rregullave korporative për mbrojtjen e privatësisë, kompanitë përgjegjëse duhet të japin një shpjegim adekuat të fakteve pa vonesë të qëllimshme. Për të dhënat e transferuara veçanërisht për kompanitë jashtë Bashkimit Evropian, kompania me seli në Bashkimin Evropian duhet të japë një shpjegim dhe të ofrojë dëshmi se pala marrëse nuk i ka shkelur kërkesat e specifikuar në këto Rregulla korporative për mbrojtjen e privatësisë dhe as nuk është përgjegjëse për ndonjë dëm të shkaktuar. Kompanitë në një rast të tillë duhet të bashkëpunojnë për të sqaruar faktet dhe do t'i japin njëra-tjetrës qasje në të gjitha informacionet e nevojshme për këtë qëllim.

(2) Subjekti i prekur i të dhënave mund të dorëzojë ankesë në Grupacionin Dojçe Telekom në çdo kohë nëse dyshon se një kompani e caktuar anëtare e Grupacionit Dojçe Telekom nuk i përpunon të dhënat e tij në përputhje me kërkesat ligjore ose dispozitat e këtyre Rregullave korporative për mbrojtjen e privatësisë. Ankesa bazë do të shqyrtohet brenda një periudhe kohore të përshtatshme dhe subjekti i të dhënave personale do të informohet siç duhet brenda një muaji për statusin e përpunimit. Kjo periudhë mund të zgjatet me dy muaj shtesë nëse është e nevojshme, duke marrë parasysh kompleksitetin dhe numrin e kërkesave, dhe subjekti i të dhënave personale duhet të informohet në mënyrë përkatëse.

(3) Nëse një ankesë ka të bëjë me disa kompani, Zyrtari i mbrojtjes së të dhënave personale i kompanisë më i njoftuar me çështjen në fjalë do ta koordinojë të gjithë korrespondencën përkatëse me subjektin e të dhënave. Zyrtari i mbrojtjes së të dhënave personale i Grupacionit ka të drejtë ta ushtrojë të drejtën e tij të zëvendësimit dhe ndërmarjes në çdo kohë.

(4) Do të vihen kanale përkatëse për paraqitjen e incidenteve lidhur me privatësinë e të dhënave (siç është një adresë e veçantë për postë e elektronike e siguruar nga Zyrtari për mbrojtjen e të dhënave personale ose kontaktit të drejtpërdrejtë online).

(5) Zyrtari për mbrojtjen e të dhënave personale të kompanisë në fjalë e informon pa vonesë Zyrtarin e mbrojtjes së të dhënave të Grupacionit për një incident lidhur me privatësinë e të dhënave, duke i përdorur proceset përkatëse të raportimit dhe do të sigurojë dokumentacionin e incidentit të privatësisë së të dhënave, i cili do të jetë në dispozicion të autoriteteve kompetente sipas kërkesës.

(6) Subjektet e të dhënave personale mund të shtrojnë kërkesë në pajtim me Seksionin pesë të këtyre Rregullave korporative për mbrojtjen e privatësisë, nëse të drejtat e tyre janë të shkelura ose nëse ata kanë pësuar çfarëdo humbjeje.

§ 26 E drejta e pyetjes dhe ankimimit

Çdo subjekt i të dhënave personale ka të drejtë në çdo kohë të kontaktojë Zyrtarin e mbrojtjes së të dhënave personale të kompanisë që përdor të dhënat e tij/saj personale me pyetje dhe ankime në lidhje me zbatimin e këtyre Rregullave korporative për mbrojtjen e privatësisë. Kompania e cila është më e njohur me lëndën ose kompania që ka mbledhur të dhënat e subjektit të të dhënave personale do të sigurojë që të drejtat e subjektit të të dhënave personale të respektohen siç duhet nga kompanitë e tjera përgjegjëse.

§ 27 Realizimi i të drejtave të subjekteve të të dhënave personale

Subjektet e të dhënave personale nuk do të vihen në pozitë të pavolitshme për ushtrimin e këtyre të drejtave. Forma e komunikimit e përdorur me subjektin e të dhënave personale – për shembull, me telefon, në mënyrë elektronike ose me shkrim – duhet ta respektojë kërkesën e subjektit të të dhënave personale, kudo ku është e mundur.

§ 28 Një ekzemplar i shtypur nga Rregullat korporative për mbrojtjen e privatësisë

Një ekzemplar i shtypur nga këto Rregulla korporative për mbrojtjen e privatësisë duhet të sigurohet me kërkesë të cilitdo person.

## Pjesa e katërt

### Organizata e mbrojtjes së të dhënave personale

§ 29 Përgjegjësi për përpunimin e të dhënave

Kompanitë janë të detyruara të sigurojnë respektimin e dispozitave ligjore për mbrojtjen e të dhënave personale si dhe me këto Rregulla korporative për mbrojtjen e privatësisë.

§ 30 Zyrtari për mbrojtjen e të dhënave personale

(1) Çdo kompani duhet të emërojë një Zyrtar të pavarur për mbrojtjen e të dhënave personale, detyra e të cilit është të sigurojë që njësitë organizative individuale të asaj kompanie të jenë të njoftuara me kërkesat ligjore dhe të brendshme të kompanisë/Grupacionin për mbrojtjen e të dhënave dhe në veçanti, me këto Rregulla korporative për mbrojtjen e privatësisë. Zyrtari për mbrojtjen e të dhënave personale duhet të përdorë masat e duhura, veçanërisht revizionet sipas zgjedhjes së rastësishme, për të mdjekur respektimin e rregullativave për mbrojtjen e të dhënave.

- (2) Kompania do të konsultohet me Zyrtarin për mbrojtjen e të dhënave të Grupacionit para se ta emërojë Zyrtarin për mbrojtjen e të dhënave personale.
- (3) Kompania duhet të sigurojë Zyrtari për mbrojtjen e të dhënave personale ta posedojë ekspertizën relevante për vlerësimin e aspekteve ligjore, teknike dhe organizative të masave për mbrojtjen e privatësisë së të dhënave.
- (4) Kompania duhet Zyrtarit për mbrojtjen e të dhënave personale t'i sigurojë burime financiare dhe kadrovike të domosdoshme për kryerjen e detyrave të tij/saj.
- (5) Zyrtari për mbrojtjen e të dhënave personale duhet t'i mundësojë të drejtë të përgjigjet drejtpërdrejt para menaxhmentit të kompanisë dhe në mënyrë organizative të lidhet me menaxhmentin e kompanisë.
- (6) Zyrtari për mbrojtjen e të dhënave personale i çdo kompanie është përgjegjës për zbatimin e kërkesave të Zyrtarit për mbrojtjen e të dhënave personale të Grupacionit dhe strategjisë së privatësisë së të dhënave të Grupacionit Dojçe Telekom.
- (7) Të gjithë sektorët e secilës kompani janë të detyruara ta informojnë Zyrtarin për mbrojtjen e të dhënave personale të kompanisë së tyre për çdo ngjarje në infrastrukturën e TI-së, infrastrukturën e rrjetit, modelet e biznesit, produktet, përpunimin e të dhënave të punonjësve dhe planet strategjike përkatëse. Zyrtari për mbrojtjen e të dhënave personale do të informohet për zhvillimet e reja në një fazë të hershme për të qenë në gjendje të sigurojë që të gjitha pyetjet lidhur me privatësinë e të dhënave të shqyrtohen dhe të vlerësohen.

### § 31 Zyrtari për mbrojtjen e të dhënave personale të Grupacionit

- (1) Zyrtari për mbrojtjen e të dhënave personale të Grupacionit i koordinon proceset e bashkëpunimit dhe dakordimit për të gjitha pyetjet e rëndësishme lidhur me mbrojtjen e privatësisë së të dhënave në kuadër të Grupacionit Dojçe Telekom. Ai i informon DKE të Grupacionit Dojçe Telekom për ngjarjet vijuese dhe përgatit projekt-rekomandime, aty ku është e nevojshme.
- (2) Është detyrë e Zyrtarit për mbrojtjen e të dhënave të Grupacionit ta zhvillojë dhe promovojë politikën e mbrojtjes së privatësisë së të dhënave të Grupacionit Dojçe Telekom, në konsultim me Zyrtarët e mbrojtjes së të dhënave të kompanive të Grupacionit kur është përkatëse. Këta Zyrtarë të mbrojtjes së të dhënave personale do ta zhvillojnë politikën e mbrojtjes së privatësisë së të dhënave për kompanitë e tyre në përputhje me politikën e Grupacionit për mbrojtjen e privatësisë së të dhënave. Zyrtari për mbrojtjen e të dhënave personale të Grupacionit dhe Oficerët për mbrojtjen e të dhënave personale prej kompanive nacionale do të takohen çdo vit për të ndarë informacionin në Takimet ndërkombëtare të liderëve për mbrojtjen e privatësisë (ngjarje ballë për ballë).

### § 32 Detyra e informimit për rast të shkeljeve

Kompania në fjalë e informon menjëherë Zyrtarin e saj për mbrojtjen e të dhënave personale për çdo shkelje ose tregues të qartë të shkeljes së rregullativave për mbrojtjen e të dhënave, në veçanti të këtyre Rregullave korporative për mbrojtjen e privatësisë. Zyrtari për mbrojtjen e të dhënave personale më pas e informon menjëherë Zyrtarin për mbrojtjen e të dhënave personale të Grupacionit nëse incidenti ka potencialin të prekë opinionin, aktualisht më shumë se një kompani, ose përfshin një humbje të mundshme prej më shumë se 500.000 euro. Zyrtari për mbrojtjen e të dhënave personale do të informojë gjithashtu Zyrtarin për mbrojtjen e të dhënave personale të Grupacionit nëse janë bërë ndryshime në ligjet e zbatueshme për Kompaninë që janë dukshëm të pafavorshme për pajtueshmërinë me këto Rregulla korporative për mbrojtjen e privatësisë.

### § 33 Verifikimi i shkallës së mbrojtjes së të dhënave

- (1) Verifikimet për të përcaktuar pajtueshmërinë me kërkesat e përcaktuara në këto Rregulla korporative për mbrojtjen e privatësisë dhe shkallën e mbrojtjes së të dhënave si rezultat i aplikimit të tyre duhet të kryhen nga Zyrtari për mbrojtjen e të dhënave personale të Grupacionit si pjesë e planit vjetor të revizionit, si dhe me përdorimin e masave të tjera, siç janë revizionet e kryera nga Zyrtarët për mbrojtjen e të dhënave personale të kompanive dhe raportimi.
- (2) Revizorët e brendshëm dhe të jashtëm duhet t'i kryejnë revizionet e Zyrtarit për mbrojtjen e të dhënave personale të Grupacionit. Vetëvlerësime të rregullta kryhen brenda Grupacionit Dojçe Telekom, nën koordinimin e Zyrtarit për mbrojtjen e të dhënave të Grupacionit. DKE i Grupacionit Dojçe Telekom duhet të informohet për rezultatet e revizioneve më të rëndësishme dhe për masat e miratuara më pas. Autoriteti përgjegjës për mbrojtjen e të dhënave merr një kopje të rezultateve të revizionit sipas kërkesës. Një organ kompetent përgjegjës për kompaninë mund të iniciojë gjithashtu një revizion. Kompania duhet të ofrojë sa më shumë mbështetje për këto revizione dhe t'i zbatojë masat që rrjedhin prej tyre.
- (3) Kompania do të marrë masa përkatëse për të hequr çdo dobësi të identifikuar gjatë revizionit dhe Zyrtari për mbrojtjen e të dhënave personale të Grupacionit do ta monitorojë zbatimin e këtyre masave. Nëse kompania nuk i zbaton masat pa arsye të justifikueshme, Zyrtari i mbrojtjes së të dhënave personale të Grupacionit do ta vlerësojë ndikimin e mbrojtjes së privatësisë së të dhënave dhe do të ndërmarrë veprimet e nevojshme, duke e përshkallëzuar çështjen kur është e nevojshme.
- (4) Zyrtarët për mbrojtjen e të dhënave personale të kompanive ose njësive të tjera organizative të angazhuar për të zbatuar revizione gjithashtu i kryejnë verifikimet në bazë të planeve për revizion të dokumentuara në formë të shkruar, për të përcaktuar nëse kompanitë i plotësojnë obligimet për mbrojtjen e të dhënave.
- (5) Në mungesë të kufizimeve ligjore, Zyrtari për mbrojtjen e të dhënave personale të Grupacionit dhe Zyrtarët për mbrojtjen e të dhënave janë të autorizuar të kontrollojnë, në të gjitha kompanitë dhe në kompaninë e tyre përkatësisht, nëse të dhënat personale përdoren në mënyrë korrekte. Kompanitë e prekura do t'i japin Zyrtarit për mbrojtjen e të

dhënave personale të Grupacionit dhe Zyrtarët për mbrojtjen e të dhënave personale qasje të plotë në informacionet që ata do t'i kërkojnë me qëllim sqarimin dhe vlerësimin e një situatë të caktuar. Zyrtari i mbrojtjes së të dhënave personale të Grupacionit dhe Zyrtarët për mbrojtjen e të dhënave personale kanë të drejtë të japin udhëzime në lidhje me këtë.

- (6) Si pjesë e revizioneve të tyre, Zyrtarët për mbrojtjen e të dhënave personale të kompanive përdorin procedura të standardizuara të cilat vlejné për të gjithë Grupacionin, për shembull revizione universale për mbrojtjen e të dhënave, gjithmonë kur është e mundur. Procedurat e tilla mund të vihen në dispozicion nga Zyrtari për mbrojtjen e të dhënave të Grupacionit.

#### § 34 Detyrimi dhe trajnimi i punonjësve

- (1) Kompanitë duhet t'i obligojné punonjësit e tyre me detyrimin e konfidencialitetit të të dhënave dhe të telekomunikacionit jo më vonë se momenti i fillimit të punësimit të tyre. Punonjësit do të marrin trajnimin e duhur për çështjet që lidhen me privatësinë e të dhënave, me marrjen e këtij detyrimi. Kompania duhet të iniciojë proceset e duhura dhe të sigurojë burime për të realizuar këtë qëllim.
- (2) Punonjësit duhet të marrin rregullisht trajnime bazë për mbrojtjen e privatësisë së të dhënave, ose të paktën çdo dy vjet. Kompanitë kanë të drejtë të zhvillojnë dhe drejtojnë kurse trajnimi të dedikuara për punonjësit e tyre. Zyrtari për mbrojtjen e të dhënave të çdo kompanie duhet ta dokumentojë zbatimin e këtyre trajnimeve dhe ta informojë Zyrtarin për mbrojtjen e të dhënave të Grupacionit në baza vjetore.
- (3) Zyrtari për mbrojtjen e të dhënave personale të Grupacionit mundet në nivel qendror të vë në dispozicion resurse dhe procese për trajnimin dhe shkarkimin e obligimit të fshehtësisë së të punësuarve të Grupacionit Dojçe Telekom.

#### § 35 Bashkëpunimi me organet kompetente

- (1) Kompanitë janë të pajtimit të bashkëpunojnë së bashku në bazë të besimit me organin kompetent përgjegjës për ta ose për kompaninë që transferon të dhëna, veçanërisht për përgjigjen e pyetjeve dhe ndjekjen e rekomandimeve.
- (2) Në rast të ndryshimit në legjislativen kompetente të një kompanie, e cila mund të ketë efekte negative domethënëse të garancive të siguruara me këto Rregulla korporatave për mbrojtjen e privatësisë, kompania e involvuar e informon organin kompetent përgjegjës për ndryshimin.

#### § 36 Kontaktet përgjegjëse për pyetje

Zyrtarët për mbrojtjen e të dhënave personale të kompanive apo Zyrtari për mbrojtjen e të dhënave personale të grupacionit janë kontaktet përgjegjëse për shtrimin e pyetjeve lidhur me këto Rregulla korporative për mbrojtjen e privatësisë. Zyrtari për mbrojtjen e të dhënave personale të Grupacionit do t'i sigurojë detajet për kontakt për Zyrtarët për mbrojtjen e të dhënave personale të kompanive me kërkesë.

Zyrtari për mbrojtjen e të dhënave personale të Grupacionit mund të kontaktohet në

[datenschutz@telekom.de](mailto:datenschutz@telekom.de)

[privacy@telekom.de](mailto:privacy@telekom.de)

+49-228-181-82001

gjatë orarit të rregullt të punës (Koha qendrore evropiane).

### **Pjesa e pestë Përgjegjësia**

#### § § 37 Fusha e zbatimit të rregullave të përgjegjësive

- (1) Kjo pjesë e Pestë e Rregullave korporatave për mbrojtjen e privatësisë ka të bëjë vetëm me përpunimin e të dhënave personale të cilat bëjnë pjesë në fushëveprimin e Rregullativës së përgjithshme për mbrojtjen e të dhënave 2016/679.
- (2) Brenda BE/EEO zbatohen dispozitat e përgjegjësive ligjore të vendit në të cilin ndodhet selia e kompanisë. Për të dhënat që nuk i nënshtrohen § 36, Pjesa 1 e RRKMP, dispozitat e përgjegjësive ligjore të vendit në të cilin kompania përkatëse që i ka mbledhur të dhënat e ka selinë e saj, ose nëse nuk ka dispozita ligjore, zbatohen kushtet e kompanisë që i ka mbledhur të dhënat.
- (3) Pjesa e dëmshpërblimit ndëshkues, ku kompania duhet të bëjë pagesë ndaj subjektit të të dhënave që e tejkalojnë vetë dëmin, përjashtohet shprehimisht si mundësi.

#### § 38 Dëmshpërblyesi

- (1) Çdo person që ka pësuar dëme si rezultat i shkeljes së një ose më shumë detyrimeve të përcaktuara në Rregullat korporatave për mbrojtjen e privatësisë nga një kompani anëtare e Grupacionit Dojçe Telekom ose nga marrësit e të dhënave të cilëve një kompani anëtare e Grupacionit Dojçe Telekom ua ka transferuar të dhënat, ka të drejtën e kompensimit përkatës në dëm të kompanive të prekura të Grupacionit Dojçe Telekom.
- (2) Subjekti i të dhënave gjithashtu ka të drejtë të kërkojë dëmshpërblim nga Grupacioni Dojçe Telekom. Nëse Dojçe Telekom e paguan dëmshpërblimin, i njëjti ka të drejtë të kërkojë kompensim nga kompanitë që janë përgjegjëse për humbjen ose të cilat e kanë angazhuar palën e tretë që e kanë shkaktuar të njëjtën.
- (3) Subjekti i të dhënave fillimisht duhet të kërkojë dëmshpërblim nga kompania e cila i ka transferuar të dhënat. Nëse kjo kompani nuk konsiderohet përgjegjëse de jure ose de fakto, atëherë Subjekti i të dhënave ka të drejtë të kërkojë



dëshmëpërblim nga kompania që i ka pranuar të dhënat. Kompania që i ka pranuar të dhënat nuk ka të drejtë të tërhiqet nga përgjegjësia përmes thirrjes në përgjegjësi të zbatuesit në rast shkeljeje.

- (4) Subjekti i të dhënave ka të drejtë në çdo kohë të dorëzojë ankimum deri tek organi kompetent përgjegjës në vendin-anëtar ku ndodhet vendbanimi i tij, vendi i punës ose vendi i shkeljes së pretenduar ose deri tek organi kompetent përgjegjës në Grupacionin Doçje Telekom.

#### § 39 Barra e dëshmisë

Barrën e dëshmisë për përdorimin përkatës të të dhënave të subjektit të të dhënave e bartin kompanitë përgjegjëse.

#### § 40 Të drejtat e shfrytëzuesve të palëve të treta për subjektet e të dhënave personale

Nëse subjekti i të dhënave personale nuk ka ndonjë të drejtë të drejtpërdrejtë, ai/ajo do të ketë të drejtën, si përdorues i palës së tretë, të paraqesë kërkesa kundër kompanive që i kanë shkelur detyrimet e tyre kontraktuale, bazuar në dispozitat e këtyre Rregullave korporative për mbrojtjen e privatësisë.

#### § 41 Vendi i kompetencës

Sipas të drejtës diskrecionale të individit, vendi i kompetencës për shtrimin e ankesave mund të jetë

- a) vendi ku individi i involvuar jeton apo
- b) në kuadër të kompetencës ku anëtarja e grupacionit ka seli apo,
- c) selinë e BE-së apo anëtares evropiane të Grupacionit me përgjegjësi të deleguara për mbrojtjen e të dhënave.

#### § 42 Arbitrazhi jashtëgjyqësor

(1) Palët e treta që besojnë se e drejta e tyre personale për privatësi është shkelur si rezultat i përpunimit faktik ose dyshimit për përpunimin e të dhënave të tyre personale, kanë të drejtë të kërkojnë që Zyrtari i mbrojtjes së të dhënave të Kompanisë të jetë arbitri i çështjes. Zyrtari për mbrojtjen e të dhënave ka të drejtë të shqyrtojë ankimumin dhe ta informojë subjektin e të dhënave për të drejtat e tij. Duke vepruar kështu, Zyrtari për mbrojtjen e të dhënave është i detyruar të ruajë konfidencialitetin e të dhënave të tjera personale të personit ankimes, përveç nëse i njëjti nuk e liron Zyrtarin për mbrojtjen e të dhënave nga një detyrim i tillë. Me kërkesë të personit të involvuar, bëhen përpjekje për t'u arritur një zgjidhje në lidhje me ankimumin, duke përfshirë subjektet e të dhënave dhe Zyrtarin e mbrojtjes së të dhënave. Një marrëveshje e tillë mund të përfshijë gjithashtu një rekomandim në lidhje me kompensimin për çdo dëm të pësuar si rezultat i shkeljes së të drejtës së subjektit të të dhënave për privatësi. Ky rekomandim është i detyrueshëm për kompanitë e involvuara nëse miratohet me pëlqim reciprok.

(2) E drejta për të shtruar ankesë pranë autoritetit kompetent përgjegjës, ose përpara autoritetit kompetent në shtetin anëtar të vendbanimit, vendit të punës ose vendit të shkeljes së pretenduar ose për të ndërmarrë veprime ligjore mbetet e paprekur.

### **Pjesa e gjashtë Dispozita përfundimtare**

#### § 43 Rishikimi dhe plotësimi i këtyre Rregullave korporative për mbrojtjen e privatësisë

Zyrtari i Privatësisë së të dhënave në nivel Grupacionit duhet t'i rishikojë rregullisht Rregullat korporative për mbrojtjen e privatësisë, të paktën një herë në vit, në mënyrë që të përcaktojë përputhshmërinë e tyre me legjislacionin në fuqi, dhe duke bërë këtë të bëjë përshtatjet e nevojshme.

Të gjitha ndryshimet dhe plotësimet e rëndësishme në këto Rregulla korporative për mbrojtjen e privatësisë që bëhen të nevojshme si rezultat i përshtatjeve të bëra në mënyrë që të pajtohen me kërkesat ligjore bien dakord me autoritetin kompetent. Ndryshimet dhe plotësimet e tilla zbatohen drejtpërdrejt për të gjitha kompanitë që kanë nënshkruar Rregullat korporative për mbrojtjen e privatësisë pas skadimit të periudhës së përshtatshme të tranzicionit.

Zyrtari i Privatësisë së të dhënave të Grupacionit duhet t'i njoftojë të gjitha kompanitë që i kanë zbatuar Rregullat korporative për mbrojtjen e privatësisë.

Zyrtarët e mbrojtjes së të dhënave të kompanive janë të detyruar të hetojnë nëse ndryshimet dhe plotësimet e këtyre Rregullave korporative për mbrojtjen e privatësisë kanë ndonjë implikim për pajtueshmërinë ligjore në vendin e tyre ose nëse ato janë në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi në vendin e tyre përkatës. Nëse kompania nuk është në gjendje të zbatojë ndryshimet dhe plotësimet për arsye të justifikuara ligjore, ajo duhet ta informojë menjëherë Zyrtarin e privatësisë së të dhënave në nivel të Grupacionit dhe autoritetin kompetent përgjegjës dhe, nëse është e nevojshme, këto Rregulla korporative për mbrojtjen e privatësisë duhet të pezullohen përkohësisht për atë kompani.

#### § 44 Lista e kontakteve dhe kompanive

Zyrtari i privatësisë së të dhënave në nivel të Grupacionit duhet të mbajë një listë të të gjitha kompanive që i kanë zbatuar këto Rregulla korporative të mbrojtjes së privatësisë, si dhe personat e kontaktit në ato kompani. Ai duhet ta përditësojë rregullisht listën dhe t'i informojë subjektet e të dhënave sipas kërkesës. Një herë në vit, autoriteti kompetent merr një listë të përditësuar të kompanive që i kanë zbatuar Rregullat e korporative për mbrojtjen e privatësisë në mënyrë të detyrueshme.

#### § 45 E drejta proceduese/klauzola e moszbatueshmërisë së dispozitave

Këto rregulla korporative për mbrojtjen e privatësisë udhëhiqen sipas të drejtës proceduese të Republikës Federale të Gjermanisë në rast të kontesteve.

Nëse dispozitat individuale të këtyre Rregullave korporative për mbrojtjen e privatësisë janë ose bëhen të pavlefshme, ato do të konsiderohen të zëvendësuara nga dispozita që përcjellin më nga afër qëllimin fillestar të këtyre Rregullave korporative për mbrojtjen e privatësisë dhe dispozitave të pavlefshme. Në rast dyshimi, në raste të tilla ose në mungesë të dispozitave përkatëse, do të zbatohen rregulloret e zbatueshme për mbrojtjen e të dhënave të Bashkimit Evropian.

#### § 46 Publikimi

Kompanitë do të vënë në dispozicion të publikut informacionin në lidhje me të drejtat e subjekteve të të dhënave dhe klauzolën e të drejtave të përdoruesve të palëve të treta në një format të përshtatshëm, si në shënimet për mbrojtjen e të dhënave në internet. Këto informacione publikohen menjëherë sapo këto Rregulla korporative për mbrojtjen e privatësisë bëhen të detyrueshme për kompaninë.

## Pjesa e shtatë Definicione dhe termine

### Anonimizimi

Anonimizimi nënkupton procesin e modifikimit të informacionit në atë mënyrë që të dhënat personale dhe faktet e tjera nuk mund të lidhen më me personin fizik që identifikohet ose mund të identifikohet, ose nuk mund të lidhen më me një person të tillë pa përpjekje të mëdha në mënyrë disproporcionale nga aspekti i kohës, kostos dhe energjisë.

### Vendime të automatizuara individuale

Kjo do të thotë vendime që kanë implikime ligjore për subjektet e të dhënave ose që kanë një ndikim të rëndësishëm negativ mbi to dhe që bazohen ekskluzivisht në përpunimin e automatizuar të të dhënave që synojnë të vlerësojnë disa aspekte personale të subjektit të të dhënave, si rezultatet e tij në vendin e punës, aftësia kreditore, stabiliteti, sjellja etj.

### Kompania

nënkupton çdo kompani që i nënshtrohet këtyre Rregullave korporative për mbrojtjen e privatësisë. Për qëllime referente, një listë e veçantë e këtyre kompanive mbahet dhe përditësohet rregullisht. Lista mund të rishikohet në çdo kohë.

### Kontrolluesi

Do të thotë person fizik apo juridik i cili i përcakton qëllimet dhe mjetet për përpunimin e të dhënave personale.

### Subjekti i të dhënave

Do të thotë cildo person fizik *për të cilin kanë të bëjnë të dhënat e përpunuara*, gjegjësisht person me të dhënat personale të së cilit vepron në kuadër të Grupacionit Dojçe Telekom.

### Grupacioni Dojçe Telekom

do të thotë Dojçe Telekom SHA dhe të gjitha kompanitë në të cilat Dojçe Telekom SHA drejtpërdrejtë apo në mënyrë të tërthortë i posedon mbi 50% pjesëmarrje ose që janë të konsoliduara plotësisht.

### Grupacioni Holding

Grupacioni Holding për momentin nënkupton Dojçe Telekom SHA, me seli në Fridrih – Ebert- Ale 140, 531 13, Bon, Gjermani.

### Të dhëna personale

Do të thotë çdo informacion që lidhet me një person fizik që identifikohet ose mund të identifikohet (subjekt i të dhënave); personi mund të identifikohet drejtpërdrejt ose tërthorazi, veçanërisht duke iu referuar një numri identifikimi ose një ose më shumë faktorëve specifikë për identitetin e tij fizik, fiziologjik, mendor, ekonomik, kulturor ose social.

### Pseudonimizimi

nënkupton përpunimin e të dhënave personale në atë mënyrë që të dhënat personale të mos mund të lidhen më me një subjekt specifik të të dhënave pa përdorimin e informacionit shtesë, me kusht që këto informacione shtesë të ruhen veçmas dhe t'i nënshtrohen masave teknike dhe organizative për të siguruar që të dhënat personale nuk mund të lidhen me një person fizik që është identifikuar ose mund të identifikohet.

### Përpunimi

nënkupton çdo operacion ose grup operacionesh të kryera mbi të dhënat personale mbi një grup të dhënash personale, automatikisht ose ndryshe, të tilla si: mbledhja, regjistrimi, organizimi, strukturimi, ruajtja, përshtatja ose ndryshimi, gjetja, konsultimi, përdorimi, zbulimi me anë të transferimit, shpërndarjes ose në një mënyrë tjetër vihen në dispozicion, barazim, kombinim, kufizim, fshirje ose shkatërrim.

### Marrësi

nënkupton çdo person fizik ose juridik, autoritet publik, agjenci ose çdo organ të cilit i zbulohen të dhënat personale, pavarësisht nëse është apo jo palë e tretë. Megjithatë, autoritetet publike që mund të marrin të dhëna si pjesë e një kërkese të vetme nuk

konsiderohen marrës.

Kategoritë e veçanta të të dhënave personale

do të thotë të dhëna që zbulojnë origjinën etnike, opinionet politike, besimet fetare ose filozofike, anëtarësimin në sindikatë ose të dhënat gjenetike, të dhënat biometrike për qëllime të identifikimit unik të një personi fizik, të dhënat shëndetësore ose të dhëna për jetën seksuale ose orientimin seksual të një personi fizik.

**Pala e tretë**

nënkupton çdo person fizik ose juridik, autoritet ose organ shtetëror, i cili nuk është subjekt i të dhënave personale, kontrollues, përpunues ose person i cili nën autoritetin e drejtpërdrejtë të kontrolluesit ose përpunuesit është i autorizuar t'i përpunojë të dhënat personale.